

Sipas dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/20, mbi Pensionet në Kosovë, të datës 29 Prill 2005, të plotësimit të Rregullores së UNMIK-ut 2001/35,

Me qëllim të ekzekutimit të Nenit 9 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/20 (Rregullorja e Pensionit), për çështjen e mbajtjes së sigurt dhe si duhet dhe kujdestarin e mjeteve dhe pensioneve, Bordi Drejtues i Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës (AQBK), në mbledhjen e tij të mbajtur më 4 prill 2007 miratoi si vijon:

## **Rregulla 8 mbi ndryshimin e rregulles për Kujdestarin e Mjeteve të Pensioneve**

### **Neni 1**

#### **Sfera dhe qëllimi i kësaj rregulle**

##### **1.1. Sfera e rregullës**

Kjo rregulle i adresohet Kujdestarit të mjeteve të pensioneve të Trustit të Pensioneve të Kursimit të Kosovës ("Trusti") dhe aty ku aplikohet, Kujdestarët e Fondit të Pensionit ose Siguruesit e mjeteve të pensionit.

##### **1.2. Qëllimi i rregullës**

Kjo rregull përshkruan disa udhëzime për kujdestari të mirë të mjeteve të pensioneve sipas dispozitave të Nenit 9 të Rregullores së Pensionit.

### **Neni 2**

#### **Dispozitat e përgjithshme**

##### **2.1. Definimi**

Te gjitha termet e shfrytëzuara në këtë Rregull janë ashtu siç janë definuar dhe caktuar në Rregulloren e Pensionit dhe/ose siç janë definuar me tutje në këtë Rregull.

“Marrëveshja për kujdestari” i referohet marrëveshjes, nga çfarëdo emër i quajtur, ndërmjet Trustit (Fondit të Pensionit ose Siguruesit të Pensionit, aty ku aplikohet) dhe Kujdestarit lidhur me kujdestarin e mjeteve të pensioneve.

“Kujdestaria e mjeteve të pensioneve” përfshinë mbajtjen e sigurt, përvetësimin dhe dispozicionin e mjeteve të pensioneve në pajtim me termet dhe kushtet e marrëveshjes themelore të kujdestarisë.

“Principet e Investimit” i referohet politikës investuese dhe zhvillimit të objektivave të investimeve të përshtatura nga entiteti i pensionit për investimin e mjeteve të pensioneve qofte të shprehura në Urdhëresën e Pensionit, Rregullat e Pensionit ose në direktivat e investimeve.

“Direktivat investuese” i referohen urdhrave dhe udhëzimeve të bëra nga entiteti i pensionit për kujdestarin duke specifikuar termet, kushtet dhe mënyrën e përvetësimit, shkarkimit dhe/ose ekspozimi i mjeteve të pensioneve. “Entiteti i Pensionit” përfshin nëse konteksti nuk tregon ndryshe, Trustin, Fondin e Pensionit dhe Siguruesin e Pensionit.

## **Neni 3**

### **Kushtet për zhvillimin e biznesit të Kujdestarit**

#### **3.1. Kushtet e Përgjithshme për Kujdestar Kosovar**

Kujdestari i mjeteve të pensioneve i cili është entitet ligjor në Kosovë duhet të plotësojë kushtet si vijojnë:

a) Formën e organizmit dhe licencës. Kujdestari duhet të jetë entitet ligjor i licencuar nga AQBK-ja në pajtim me rregullat bankare dhe të autorizuar që të zhvillojë biznes bankar duke përfshirë kujdestarin dhe ruajtjen e mjeteve.

b) Përshtatja me Rregulloren e Pensionit, Rregullat e AQBK-se mbi Pensionet dhe ligjet tjera të aplikueshme, statutet, rregulloret, dhe rregullat. Kujdestari i mjeteve të pensioneve mendohet që të pajtohet dhe vazhdon të përputhet me dispozitat e Rregullores së Pensionit, këto Rregulla dhe Ligjet tjera, rregulloret dhe rregullat e lëshuara nga autoritetet kompetent që ndikojnë në kujdestarin e mjeteve të pensioneve.

c) Përgjegjësitë fiduciare. Kujdestari merr detyrat fiduciare dhe përgjegjësitë për entitetin e pensionit, pjesëmarrësit dhe përfituesit e rregullimit pensional për transaksionet e matura që përfshijnë mjetet e pensioneve nën kujdestarin e tij. Kjo detyrë fiduciare dhe përgjegjësi mendohet të përfshihet në çdo marrëveshje kujdestare në lidhje me mjetet e pensioneve.

d) Ndarja e mjeteve te pensionit. Kujdestari duhet te mbaj, administroj, mbaj shënime, llogarit dhe duhet te beje raporte mbi mjetet e ruajtura veçante prej secilës dhe prej secilës llogari te trustit te entitetit te pensionit ose prej te gjitha llogarive te trustit ose kujdestarisë qe i përkasin personave tjerë ose entitetit.

e) Mbikëqyrja suplementare dhe mbikëqyrja rregullatorë. Kujdestari dhe te gjithë drejtoret e tij, oficeret dhe nëpunësit te cilët ushtrojnë ose mund te ushtrojnë ndonjë funksion ne lidhje me mjetet e pensioneve pajtohen qe ti nënshtrohen mbikëqyrjes rregullatorë dhe mbikëqyrjes suplementare nga Departamenti i Pensioneve/ AQBK ne lidhje me zhvillimin e biznesit te tij si kujdestar i mjeteve te pensioneve.

### **3.2. Kujdestaret e vendosur jashtë Kosovës**

Kujdestaret te cilët ndodhen jashtë Kosovës duhet te jenë te licencuar nga banka ose shërbimet financiare ose tregje kapitale nga anëtarët shtetas te BE-së apo OECD-se dhe duhet te sigurojnë për Trustin dhe AQBK-ne dëshmi te licencës se tille.

## **Neni 4**

### **Puna e Kujdestarit te Mjeteve te Pensioneve**

#### **4.1. Detyrat dhe përgjegjësitë**

Për ruajtjen e mjeteve te pensioneve Kujdestari duhet te:

- a) Pranoj dhe ruaj letrat e fondeve, titujt dhe faktet e mjeteve te pensioneve.
- b) Te mbaj shënime adekuate te investimeve qe nuk ju lëshohen certifikata për mjetet e pensioneve dhe te siguroj një vazhdë adekuate te transaksioneve qe përfshijnë ato.
- c) Te pranoj dhe mbaj kopjet e dokumenteve te setelmentit qe shoqërojnë transferin, lëshimin apo përvetësimin e fondeve qe përbejnë mjetet e pensioneve.
- d) Te themelojnë dhe mbajnë regjistrin e mjeteve te pensioneve nen kujdestarin e tij ne mënyre qe te siguroj një vazhde adekuate te të gjitha transaksioneve qe ndikojnë ne mjetet.
- e) Te siguroj te gjitha informatat e kërkuara nga Trusti dhe entitetet tjera te pensioneve me te cilat ka marrëveshje kujdestare qe janë te nevojshme për ata

qe te përshtaten me kërkesat e Rregullores se Pensionit, këto Rregulla dhe ligjet tjera te aplikueshme, statutet, rregullat ose rregulloret nga autoritetet kompetent.

f) Te siguroj se çdo marrëveshje, kërkesë ose udhëzim te bere nga Menaxher(et) e Mjeteve (ne rastin e Trustit), Bordi i Drejtoreve, administratoret ose Menaxheret e Pronave ( ne rast te Fondit te Pensionit dhe Siguruesve te Pensionit), për përvetësim dhe dispozicion te mjeteve te pensioneve, konform me termet dhe kushtet e raporteve themelore te principeve te investimit dhe direktivave te investimit dhe përshtatja me kërkesat e parashikuara ne Rregulloren e Pensionit dhe këto Rregulla për investimet e mjeteve te pensioneve.

g) Përbushja e instruksioneve te Trustit, Bordi i Drejtoreve ose administratori (ne rast te Siguruesit te Pensionit ose Fondit te Pensionit) qe janë ne pajtim me termet e raportit themelore te principeve te investimit, direktivave te investimeve dhe kërkesat e Rregullores se Pensionit, këtyre Rregullave dhe ligjet tjera te tilla, statutet, rregullat, ose rregulloret duke involvuar mjetet e pensioneve dhe trustet.

h) Te siguroj qe mjetet e pensioneve janë investuar ne pajtim me Rregulloren e Pensionit, këto Rregulla, ligjet e tjera te aplikueshme, statutet, rregulloren dhe rregullat e lëshuara nga autoritetet kompetent ne lidhje me mjetet e pensioneve dhe qe ato investime qe janë bere ne pajtim me termet e deklaratës (ve) te principeve te investimit dhe te direktivave te investimit.

i) Te siguroj se Menaxheri (et) i Pronave përbush obligimet e tij ligjore ne investimin e mjeteve te pensioneve.

j) Te siguroj se ka themeluar një sistem adekuat dhe efektiv te kontrollit intern për kujdestari te mjeteve te pensioneve, çdo transaksion qe përfshin përvetësimin dhe dispozicionin e mjeteve dhe mjaftueshmëria dhe përpikshmëria e kontabilitetit dhe informata financiare ne lidhje me to.

k) Ti raportohet me përpikëri Trustit, Fondit te Pensionit dhe/ose Siguruesit te Pensionit nëse është i aplikueshëm, për çdo investim te mjeteve te pensionit, qe mendohet se ka bere thyerje ose shkelje te kërkesave te Rregullores se Pensioneve, këtyre Rregullave, dhe ligjeve tjera te aplikueshme, statutet, rregulloret ose rregullat ne lidhje me mjetet e pensioneve nen kujdestarinë e tij, ose duke pasur parasysh kryerjen si duhet te detyrave fiduciare dhe obligimeve te trusteeve drejtuese, ne përgjithësi.

l) Te përgatiten raportet e rregullta te kërkuara sipas Rregullës 6 te kësaj rregulle brenda kohës se parashikuar.

m) Ti raportohet me përpikëri Trustit, (Fondit te Pensionit dhe Siguruesit te Pensionit, nëse aplikohet) si dhe AQBK-se çdo informate qe mund te marrin dhe qe mund te rrezikoj sigurinë e mjeteve te pensioneve për shkak te akteve te

shmangieve te ngarkuara te trusteeve ose ndonjërit prej anëtareve te tij, administratorit, Menaxherit(ve) te Mjeteve ose ndonjë person qe ka liri veprimi dhe/ose kontrollon ne investimet dhe kujdestarinë e mjeteve te pensioneve, duke përfshire ndonjë informatë te pafavorshme për entitetet e tilla dhe/ose individët qe mund te ekspozojnë mjetet e pensioneve ndaj rrezikut te panevojshëm te humbjes ose te çdo kushti qe sugjeron thyerjen ose shkeljen e Rregullores se Pensionit, këtyre Rregullave ose te ndonjë detyre ligjore ose fiduciare ose obligimi.

- n) Ti raportohet me përpikëri dhe ne mënyre te drejtpërdrejt AQBK-se ndonjë informatë, e njohur qe mund te involvoj ose sugjeron mashtrim, pandershmëri ose keqpërdorim te mjeteve te pensionit e ngarkuar nga ndonjë entiteti, trusti ose individi; ose kur trupat drejtues te entiteteve te mjeteve te pensioneve dështon, ose besohet me arsye ne dështim, ne adresimin ose ndërmarrjen e veprimeve përmirësuese qe te sanohet thyerja ose shkelja e detyrave ligjore ose fiduciare te kërkuara nga bordi i drejtores, administratori (et), menaxheri (et), e mjeteve ose personat tjerë qe kanë fuqi veprimi dhe kontroll ne mjetet e pensioneve.

## **Neni 5**

### **Marrëveshja për Kujdestari**

#### **5.1 Kërkesat e marrëveshjes**

Asnjë kujdestar nuk do te pranoj, marr, përvetësoj ose disponoj mjetet e pensioneve ose titujt, sigurinë, ose dokumentet e ngjashme, memorandume ose shënime qe kanë te bëjnë me mjetet e pensioneve, nëse nuk ka marrëveshje për ekzekutim dhe për kujdestari me Trustin, Fondin e Pensionit ose Entitetin e Pensionit, aty ku aplikohet).

#### **5.2 Forma dhe përmbajtja e Marrëveshjes për Kujdestari**

Çdo marrëveshje për kujdestari duhet te jetë me shkrim, e nënshkruar nga oficeret qe janë te autorizuar me vendimin e bordit, te bordit drejtues te entitetit te pensionit dhe Kujdestarit, duke caktuar ne minimum, veçantitë e kërkesave qe vijojnë:

- a) Detyrat specifike dhe përgjegjësitë e Kujdestarit.
- b) Mënyra me te cilën Kujdestari zhvillon detyrat dhe përgjegjësitë e tij.
- c) Pagesa e Kujdestarit dhe mënyra me te cilën këto taksa dhe tatime janë caktuar nëse janë pajtuar si përqindje e mjeteve te pensioneve.

- d) Një Garanci te përgjithshme se te gjitha kërkesat e Rregullores se Pensionit dhe këtyre Rregullave ne lidhje me kujdestarin e mjeteve te pensioneve kanë qene dhe do te jenë vazhdimisht, te kënaqur me shërbimet nga kujdestari.
- e) Marrëveshja se te gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e kërkuara te Kujdestarit sipas Rregullores se Pensionit, kësaj Rregulle dhe ligjet tjera te aplikueshme te AQBK-se janë inkorporuar ne marrëveshje.
- f) Një dispozitë dem shpërblyese ose “hold harmless” qe entiteti i pensionit, bordi drejtues i tij, mjetet e pensioneve, pjesëmarrësit dhe përfituesit janë te mbajtur te padëmtuar, dhe do te dëmshpërblehen si duhet nga Kujdestari, për te gjitha shpenzimet e pavend, tatimet, humbjet ose dëmtimet, ose detyrimet e krijuara ndaj mjetet e pensioneve për shkak te mashtrimit, pandershmërisë ose akteve neglizhente ose shmangieve te Kujdestarit, drejtoreve te tij, oficerëve, agjenteve dhe/ose nëpunësve.
- g) Procedurat dhe kërkesat për përfundim te marrëveshjes dhe koha dhe mënyra me te cilën mjetet nen kujdestari janë transferuar tjetërkund ose te një Kujdestari të ri.

## **Neni 6**

### **Kërkesat Kujdestare për Investime ne Open-End Vehicles**

#### **6.1 Te aplikueshëm për Trustin**

- a) Mjetet e Trustit te investuar nëpërmes Open-End Vehicles nuk u nënshtrohen kërkesave te Nenit 9 te Rregullores se Pensionit dhe mund te mbahen përmes kërkesave kujdestare te Open-End Vehicles duke përdorur formën e marrëveshjes se kujdestarisë.
- b) Bordi Drejtues duhet te shqyrtoj rregullimet e kujdestarisë te “Open-End Vehicle” dhe te përcaktoj se janë te përshtatshëm, kujdestari do te verifikoj se “Open-End Vehicle përmbush obligimet e tij ligjore ne relacion me mjetet e përbashkëta ne lidhje me përvetësimin, dispozicionin dhe ruajtjen e mbajtësve ne “pool”.
- c) Bordi Drejtues do te ndërmarr hapa qe te siguroj se “Open-End Vehicle” ka themeluar sistem adekuat dhe efektiv te kontrollit te brendshëm për

ruajtje dhe menaxhment te mjeteve te përbashkëta (“pooled assets”) duke dokumentuar te gjitha blerjet dhe shitjet dhe transaksionet relevante.

## **6.2 Te Aplikueshëm për Fondin e Pensioneve dhe Siguruesit e Pensioneve**

- (a) Mjetet e Pensioneve te investuar nëpërmes Fondit te Pensioneve ose Siguruesit e Pensioneve nëpërmes “Open-End Vehicles” nuk u nënshtrohen kërkesave te Nenit 9 te Rregullores se Pensionit dhe mund te mbahen përmes marrëveshjeve te kujdestarisë te “Open-End Vehicles”.
- (b) Fondi i Pensioneve dhe Siguruesit e Pensioneve qe përdorin Open-End Vehicles duhet te shqyrtojnë përshtatshmërinë e marrëveshjes për kujdestari dhe te përcaktoj se janë te mjaftueshëm për mbrojtjen e mjeteve te pensioneve.

## **Neni 7**

### **Hyrja ne fuqi**

Kjo rregull do te hyj ne fuqi me 16 Prill 2007.

Michel Svecchine  
Drejtori i Përgjithshëm